



**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"YOKOHASAKI LTD." Sh.p.k.**

Sot, më 14.08.1995, në Tiranë, zotërinjtë:

1. Marco Giovanni DONATI, lindur në Palo del Colle (Bari) me 03.02.1959 dhe banues në Modugno (Bari), Via Roma, 76.
 2. Giuseppe PALMISANO, lindur në Bari me 8.05.54, dhe banues në Modugno, Via Porto Torres, 13.
 3. Gianfranco LIUZZI, lindur në Locorotondo (Bari) me 06.04.1947, dhe banues në Bari, Viale Lenin, 11.
- u bashkuan për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe në unanimitet vendosën:

Neni 1

Të krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me kapital tërësisht të huaj, që emërohet "YOKOHASAKI LTD." Sh.p.k.

Neni 2

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, Rruga Tefta Tashko, 7 ku do të jetë edhe selia e saj administrative.

Ajo ka të drejtë të krijojë seli të dyta, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, sipas ligjit.

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë në këtë akt themelimi është 10 vjet. Aktiviteti i saj fillon nga momenti i krijimit të saj dhe i regjistrimit në organet kompetente.

Palanisandereff

Marco Giovanni Donati

Gianfranco Liuzzi

Neni 4

Shoqëria "YOKOHASAKI LTD." Sh.p.k. ka si objekt të të përgjithshëm të saj investimin dhe kontribuimin për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë, nëpërmjet:

1. Prodhimi, perpunimi, dhe riparimi goma për makineri të ndryshme dhe prodhime të tiera me lëndë goma.
2. Prodhim makineri për perpunimin e artikujve gome.
3. Import - export të lëndës së parë, dhe produkte të gatshme dhe gjysme të gatshme, edhe makineri.
4. Kryerjen e aktivitetit të transportit për vetë dhe për të tretet si për brenda vendit dhe jashtë shtetit.
5. Ajo mund të administrojë dyqane, si për llogari të saj ashtu edhe për llogari të të tretëve, gjithnjë në lidhje me objektin e shoqërisë. Gjithashtu mund të kryejë operacione të çfarëdolloji, mobiliare (mbi pasurinë e lujtshme) dhe imobiliare (mbi pasurinë e palujtshme) që konsiderohen si të nevojshme apo të dobishme për plotësimin e objektit të shoqërisë.
6. Krijimit të një rrjeti prodhimi, me ndërmarrje të mesme dhe të vogla, në fushën e prodhimit të produkteve të ndryshme.
7. Kryerjes së operacioneve financiare e bankare të çdo lloji, kërkimit të garancive pranë instituteve të kreditit dhe dhënies së garancive reale në favor të subjekteve juridikë shqiptarë dhe të huaj.

Neni 5

Kapitali shoqëror është 100.000 lekë.

Kontributi i ortakëve në kapitalin shoqëror është si vijon:

- | | |
|--------------------------|---|
| 1. Marco Giovanni DONATI | 25.000 Lek ose 25% e kapitalit shoqëror |
| 2. Giuseppe PALMISANO | 25.000 Lek ose 25% e kapitalit shoqëror |
| 3. Gianfranco LIUZZI | 50.000 Lek ose 50% e kapitalit shoqëror |

Kapitali shoqëror është i ndarë në 100 kuota multiple nga 1.000 lekë secila. Fitimi neto i shoqërisë do të ndahet sipas kuotave të kapitalit social.

Palmsano

Marco Giovanni Donati

Gianfranco Liuzzi

Asambleja e ortakëve mund të rrisë kapitalin shoqëror dhe numrin e ortakëve me shumicën prej 3/4 e votave të kapitalit shoqëror.

Neni 6

Shoqëria drejtohet nga administratori zoti Gianfranco LIUZZI, të emëruar nga asambleja deri në dorëheqje apo në zëvendësimin e tij. Në mungesë të këtij të fundit të gjitha të drejtat dhe detyrat i kalojnë ortakut të dytë i cili është i detyruar t'i referojë administratorit, me arritjen e tij, gjithshka mbi aktivitetin e kryer.

Neni 7

Ortakët janë bashkëpronarë në shoqërisë proporcionalisht me kuotat përkatëse të pjesëmarrjes në kapitalin shoqëror.

Neni 8

Shoqëria "YOKOHASAKI LTD." Sh.p.k. është subjekt juridik shqiptar dhe aktiviteti i saj bazohet në legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e statutit të saj.

Neni 9

Shpenzimet e nevojshme për krijimin e shoqërisë janë në ngarkim të shoqërisë.

Neni 10

Ky akt themelimi është hartuar në 6 kopje origjinale dhe pasi u miratua, u firmos nga ortakët.

ORTAKËT

1. Marco Giovanni DONATI

MARCO GIOVANNI DONATI

Marco Giovanni Donati

2. Giuseppe PALMISANO

Palmisano Giuseppe

PALMISANO GIUSEPPE

3. Gianfranco LIUZZI

Gianfranco Liuzzi

GIANFRANCO LIUZZI

**SHOQËRIA "YOKOHASAKI LTD." Sh.p.k.
TIRANË**



**STATUT
I SHOQËRISË "YOKOHASAKI LTD." Sh.p.K.**

Në bazë të protokollit të mbledhjes datë 30.10.1996, në të cilën shprehet vullneti i ortakëve Marco Giovanni DONATI, Giuseppe PALMISANO, Gianfranco LIUZZI për krijimin e shoqërisë dhe të statutit të saj si edhe në bazë të ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare", aktiviteti i shoqërisë do të organizohet dhe drejtohet në bazë të normave të këtij statuti.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Parimet dhe normat e këtij statuti janë formuluar në bazë të vullnetit të ortakëve dhe sipas kërkesave të Ligjit për Shoqëritë. Ato rregullojnë aktivitetin dhe strukturën e shoqërisë dhe janë të formës së prerë.

Neni 2

Për probleme dhe çështje që nuk gjejnë zgjidhje në këtë statut, do të zbatohen kërkesat e Ligjit për Shoqëritë, për Regjistrin Tregtar, të ligjit për investimet e huaja dhe të Kodit Civil.

EMËRTIMI, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

Neni 3

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar emërohet "YOKOHASAKI LTD." Sh.p.k.

Shoqëria është person juridik dhe ushtron aktivitetin e saj në bazë të aktit të themelimit, dhe drejtohet nga ky statut dhe nga Legjislacioni Shqiptar.

Polen'ambareff

Marco Giovanni Donati

Giuseppe Palmisano

Neni 4

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Tiranë, Rruga Tefta Tashko, 7, ku do të jetë edhe selia e saj administrative, tel. 33110.

Ajo mund të krijojë seli të dyta, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, në bazë të ligjit.

Neni 5

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është 10 vjet. Aktiviteti i saj fillon nga momenti i krijimit të saj dhe të regjistrimit në organet kompetente.

Neni 6

Shoqëria "YOKOHASAKI LTD." Sh.p.k. ka si objekt të të përgjithshëm të saj investimin dhe kontribuimin për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë, nëpërmjet:

1. Prodhimi, perpunimi, dhe riparimi goma për makineri të ndryshme dhe prodhime të tiera me lëndë goma.
2. Prodhim makineri për perpunimin e artikujve gome.
3. Import - export të lëndës së parë, dhe produkte të gatshme dhe gjysme të gatshme, edhe makineri.
4. Kryerjen e aktivitetit të transportit për vete dhe për të tretet si për brenda vendit dhe jashtë shtetit.
5. Ajo mund të administrojë dyqane, si për llogari të saj ashtu edhe për llogari të të tretëve, gjithnjë në lidhje me objektin e shoqërisë. Gjithashtu mund të kryejë operacione të çfarëdolloji, mobiliare (mbi pasurinë e lujtshme) dhe imobiliare (mbi pasurinë e palujtshme) që konsiderohen si të nevojshme apo të dobishme për plotësimin e objektit të shoqërisë.
6. Krijimit të një rrjeti prodhimi, me ndërmarrje të mesme dhe të vogla, në fushën e prodhimit të produkteve të ndryshme.
7. Kryerjes së operacioneve financiare e bankare të çdo lloji, kërkimit të garancive pranë instituteve të kreditit dhe dhënies së garancive reale në favor të subjekteve juridikë shqiptarë dhe të huaj.

KAPITALI SHOQËROR DHE KUOTAT

Neni 7

Kapitali shoqëror është 100.000 lekë.

Kontributi i ortakëve në kapitalin shoqëror është si vijon:

- | | |
|--------------------------|---|
| 1. Marco Giovanni DONATI | 25.000 Lek ose 25% e kapitalit shoqëror |
| 2. Giuseppe PALMISANO | 25.000 Lek ose 25% e kapitalit shoqëror |
| 3. Gianfranco LIUZZI | 50.000 Lek ose 50% e kapitalit shoqëror |

Giuseppe Palmisano *Marco Giovanni Donati* *Gianfranco Liuzzi*



Kapitali shoqëror është i ndarë në 100 kuota multiple nga 1.000 lekë secila.

Fitimi neto i shoqërisë do të ndahet sipas kuotave të kapitalit social.

Asambleja e ortakëve mund të rrisë kapitalin shoqëror dhe numrin e ortakëve me shumicën prej 3/4 e votave të kapitalit shoqëror.

Në rast rritjeje, çdo ortak ka të drejtë të abstenojë nënshkrimin e kapitalit të ri dhe ka të drejtë të tërhiqet nga shoqëria brenda 30 ditësh nga vendimi, në rast të kundërt mbetet ortak në shoqëri duke ruajtur kuotat e mëparshme.

Ortakët duhet të derdhin pa qenë nevoja e ndonjë vendimi, në arkën e shoqërisë, shumat e konsideruara si të nevojshme nga organi administrativ, për funksionimin e mirë të shoqërisë, proporcionalisht me kuotat e tyre të pjesëmarrjes, duke mbajtur parasysh rritje të ardhme të kapitalit shoqëror, pa të drejtë interesi.

Kuotat emërore janë të transferueshme me dokument midis të gjallëve ose trashëgimtarëve në raste vdekje.

Ortaku që dëshiron t'ja tjetërsojë një të huaji kuotat e tij ose një pjesë të tyre, duhet të legalizojë kërkesën e tjetërsimit nëpërmjet një letre rekomande duke i bërë të njohur çmimin dhe mënyrat e tjetërsimit, shoqërisë dhe ortakëve të tjerë, të cilët kanë të drejtën e parablerjes në proporcion me kuotat e pjesëmarrjes së tyre në kapital.

Në rast se njëri nga ortakët heq dorë qoftë edhe pjesërisht nga blerja e kuotave të ofruara, kuotat të cilat janë refuzuar do të shtohen në favor të ortakëve të tjerë gjithnjë në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre.

Ortakët që kanë të drejtën e parablerjes, sidoqoftë, duhet të blejnë, nëse janë pro kuotës, të gjithë kuotën e vënë në shitje.

Nëse asnjëri nga ortakët nuk ushtron të drejtën e parablerjes dhe nëse shoqëria nuk komunikon vendimin e saj brenda 30 ditësh nga njoftimi i fundit, miratimi konsiderohet i dhënë.

Në qoftë se shoqëria e kundërshton këtë dhënie, por sidoqoftë nuk i komunikon brenda tre muajsh nga njoftimi i fundit i sipërpërmendur, subjektet të cilave do t'u shiten kuotat sipas kushteve të njoftuara, ortakët tjetërsues është i lirë t'ja shesë kuotën e tij të tretëve, sipas kushteve të njoftuara. Kjo e drejtë duhet të ushtrohet brenda 60 ditësh nga njoftimi i fundit.

Polun'sambur

Luana Gjermani

Jacobi

Prof. Dr. Ilir

Në mungesë të njoftimit, ortakët kanë të drejtë t'ja shesin kuotat blerësit të mundshëm me çmimin që rezulton nga bilanci i fundit i miratuar.

Cedimi (kalimi) që kryhet duke shkelur këto norma nuk mund të regjistrohet në librin e ortakëve.

E drejta e parablerjes hiqet edhe në rastin e lënies (cedimit) së të drejtave reale të gëzimit të një të drejte dhe në rast pengu.

Shoqëria mund të shfrytëzojë kapital të huaj, në përputhje dhe duke respektuar ligjet në fuqi.

ASAMBLEJA

Neni 8

Asambleja e ortakëve, e krijuar rregullisht, përfaqëson tërësinë e ortakëve dhe të vendimeve të tyre, të mara në përputhje me ligjin dhe me statutin e shoqërisë. Në të marrin pjesë të gjithë ortakët, edhe ata jo të pranishëm ose kundërshtues, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.

Çdo ortak ka të drejtën e të paktën një vote, kuotat më të mëdha se 1.000 Lekë kanë të drejtën e një vote për çdo një mijë Lekë të nënshkruar dhe të derdhur.

Neni 9

Asambleja e ortakëve, si e zakonshme ashtu edhe e jashtëzakonshme, mund të mbledhet edhe jashtë selisë së shoqërisë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, duhet të komunikohet me letër rekomande nëpër banesat e ortakëve që rezultojnë nga libri i ortakëve, të paktën 15 ditë përpara ditës së fiksuar për mbledhje.

Në letër duhet treguar vendi, dita, ora e mbledhjes, lista e çështjeve që do të trajtohen.


Në asamble kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë ata që rezultojnë të regjistruar në librin e ortakëve në momentin në të cilin mbahet mbledhja.

Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një person tjetër në asamble me delegim me shkrim, me kusht që përfaqësuesi të jetë edhe ai ortak, por jo administrator, apo punonjës i administratës shtetërore.

Asambleja e zakonshme duhet të thirret të paktën një herë në vit brenda gjashtë muajsh nga mbyllja e aktivitetit të shoqërisë.

Asambleja e jashtëzakonshme thërritet për vendime në kompetencë të administratorit.

Asambleja duhet të mbledhet pa vonesë, në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.



Sidoqoftë, në mungesë të formaliteteve të mësipërme, asambleja konsiderohet rregullisht e krijuar, kur paraqitet i gjithë kapitali shoqëror, dhe marrin pjesë të gjithë ortakët dhe ekspertët kontabël, nëse ekzistojnë. Në një rast të tillë, secili nga pjesëmarrësit mund të kundërshtojë diskutimin e çështjeve mbi të cilat mendon se nuk është informuar plotësisht.

Neni 10

Asambleja kryesohet nga administratori i shoqërisë, dhe në rast mungese të tij nga ortaku më i madh në moshë.

Për mbajtjen e poçes verbalit administratori i asamblesë emëron një sekretar që mund të mos jetë ortak, me përjashtim të rasteve kur poçes verbali mbahet nga një noter.

Neni 11

Asambleja e zakonshme vendos në mënyrë të vlefshme në mbledhjen e saj të parë me votën e favorshme të ortakëve që përfaqësojnë shumicën prej 60% të kapitalit shoqëror dhe në mungesë të një vendimi me shumicën prej 40%.

Asambleja e jashtëzakonshme vendos në mënyrë të vlefshme në mbledhjen e saj të parë me votën e favorshme të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 65% të kapitalit shoqëror dhe në mbledhjen e dytë me votën e favorshme të ortakëve që përfaqësojnë më shumë se sa gjysma e kapitalit shoqëror.

Në qoftë se asambleja nuk arrin të plotësojë brenda një dite diskutimin e çështjeve në rend të ditës, vazhdimi i mbledhjes do të bëhet ditën pasuese, pa qenë nevoja e një lajmërimi të dytë.

Neni 12

Të gjitha vendimet e asamblesë do të verbalizohen në librin përkatës dhe poçes verbali duhet të firmoset nga administratori ose nga sekretari që mund të mos jetë ortak i shoqërisë dhe që është emëruar nga administratori i asamblesë, me përjashtim të rasteve që në bazë të ligjit poçes verbali duhet të mbahet nga një noter.

Kundërshtimet e mundshme të vendimeve duhet të paraqiten në bazë të ligjeve në fuqi.

Polpen'sandri

Arben Gaxhiu Jaxhi

Prof. Dr. Ismail

ADMINISTRIMI

Neni 13

Shoqëria administrohet nga administratori që zgjidhet nga asambleja, deri në dorëheqje apo në zëvendësimin e tij.

Në mungesë të këtij të fundit administrimi i shoqërisë dhe gjithë të drejtat e administratorit i kalojnë ortakut të dytë, i cili është i detyruar të përgjigjet për gjithë aktivitetin e tij përpara administratorit, me kthimin e tij.

Administratori ka të drejtën e rimborsimit të shpenzimeve të bëra për zyrën. Për pagesa të tjera vendos asambleja.

Organi administrativ ka fuqi të plota pa asnjë kufizim dhe dallim për veprime të administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, në fushën e administrimit të shoqërisë për operacione të vendosura që më parë dhe për sa ligji dhe statuti ja rezervon kompetencës së asamblesë.

Këto fuqi mund të delegohen tërësisht ose pjesërisht edhe me emërimin e një administratori të deleguar, prokurorë specialë apo të përgjithshëm.

Nga fuqitë e administrimit të jashtëzakonshëm nënkuptohen të përjashtuara ato të drejta që nga ligji dhe statuti i rezervohen në mënyrë të prerë asamblesë.

Neni 14

Proçes verbalet e mbledhjes së asamblesë do të nënshkruhen nga administratori i shoqërisë.

Neni 15

Përdorimin i firmës për shoqërinë dhe për pagesa të ndryshme nëpërmjet bankës e ka administratori i shoqërisë. Në mungesë të tij kjo e drejtë i kalon ortakut të dytë.

Për veprime që kryhen nëpërmjet bankës janë të nevojshme dy firma, që do të jenë të dy ortakëve të shoqërisë.

RAPORTET E PUNËS

Neni 16

Administratori ka të drejtë të punësojë persona, të përcaktojë kohën e punës dhe pagesën e tyre.

Robinson

Mario Gervani Javati

Georgios

Neni 17

Raportet midis shoqërisë dhe vartësve rregullohen nga kontrata e punës, në të cilën shprehen rigorozisht të gjitha të drejtat që ligji ju njuh të punësuarve.

EKSPERTËT KONTABËL

Neni 18

Asambleja e ortakëve mund të zgjedhë një ose më shumë ekspertë kontabël, funksione dhe kohëzgjatja e të cilëve në detyrë rregullohet nga dokumenti (kontrata) e emërimit.

Ekspertët kontabël paguhen me shpërblimin e vendosur nga asambleja dhe iu kthehen të gjitha shpenzimet e bëra për zyrën e tyre.

BILANCI DHE NDARJA E FITIMIT

Neni 19

Aktiviteti i shoqërisë mbyllet në 31 Dhjetor të çdo viti.

Në fund të çdo viti administratori merr masa për hartimin e bilancit të aktivitetit sipas afateve dhe mënyrave të parashikuara nga ligji të cilit i bashkangjitet një relacim mbi mbarëvajtjen e shoqërisë.

Neni 20

Bilanci i shoqërisë dhe dokumentacioni i nevojshëm duhet të miratohen nga asambleja e ortakëve brenda tre muajsh nga dita e fundit e ushtrimit të aktivitetit për çdo vit.

Neni 21

Fitimi neto që rezulton nga bilanci vjetor do të ndahet në këtë mënyrë:

a) 5% shkon në fondin e rezervave, i cili mund të përdoret me miratimin e asamblesë së ortakëve;

b) pjesa tjetër vihet në dispozicion të asamblesë për t'ju ndarë ortakëve dhe/ose për të tjera destinacione të mundshme.

Polimisoruff

Luana

Gravari

Janeti

Gravari

SHKRIRJA E SHOQËRISË DHE LIKUJDIMI

Neni 22

Aktiviteti i shoqërisë mbyllet kur bilancet e shoqërisë rezultojnë jo fitimprurëse, kur skadon afati i përcaktuar në aktin e themelimit ose me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 23

Me arritjen në çfarëdolloj kohe dhe për çfarëdolloj shkak në shkrirjen e shoqërisë, asambleja e ortakëve përcakton mënyrat e likujdimit dhe emëron një ose më shumë likujdues duke përcaktuar fuqitë dhe pagesën e secilit.

Neni 24

Për çdo lloj problemi që mund të lindë midis ortakëve ose midis ortakëve dhe shoqërisë, në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e normave të këtij statuti shoqëror, zgjidhja do të bëhet nga një juri arbitrazhi i përbërë nga tre anëtarë të emëruar një nga secila palë dhe i treti duhet të jetë një avokat, në rast të kundërt vendimi do t'i lihet gjyqimit të organeve kompetente shqiptare dhe të Dhomës së Tregtisë të Romës.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 25

Asambleja e ortakëve mund të ndryshojë natyrën e shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri komandite të thjeshtë vetëm me konsensusin e plotë të ortakëve, ndërsa ndryshimi në shoqëri anonime bëhet me miratimin e 3/4 të kapitalit shoqëror.

Neni 26

Ndalohej konkurrenca midis ortakëve për të njëjtin objekt të aktivitetit.

Neni 27

Të gjitha vendimet, kundërshtimet dhe sugjerimet e organeve drejtuese të ortakëve të shoqërisë, do të paraqiten në një libër protokolli që do të ruhet sipas ligjit për arkivat.

Polim Sulej

Isa Qeremisi

Qeremisi

Neni 28

Mosmarrëveshjet ndërmjet shoqërisë "YOKOHASAKI LTD." Sh.p.k., ortakëve, të punësuarve dhe të tretëve zgjidhen me marrëveshje midis tyre, ose në të kundërt nga organet gjyqësore të rrethit.

Neni 29

Shoqëria duhet të ketë vulën e saj. Vula duhet të ketë stemën dhe të shkruajturat e nevojshme që tregojnë emrin e shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES

- 1. Marco Giovanni DONATI *Marco Giovanni Donati* MARCO GIOVANNI DONATI
- 2. Giuseppe PALMISANO *Giuseppe Palmisano* PALMISANO GIUSEPPE
- 3. Gianfranco LIUZZI *Gianfranco Liuzzi* GIANFRANCO LIUZZI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

NR *1686/* REP
 NR *3317* KOL

VERTETIM

Sot ne daten 1.11.1996 perpara meje Noteres Mimoza Sadushi, Notere ne qytetin e Tiranës, u paraqiten personalisht personat e mesiperm per identitetin e te cileve u sigurova nga pasaportat e tyre me dhore me zotesi juridike per te vepruar te cilet deklaruan se kane hartuar jashte kesaj zyre aktin e mesiperm i cili shpreh vullnetin e tyre dhe pasi e nenshkruan ate perpara meje une e vertetova ate sipas ligjit.

NOTERE



MIMOZA SADUSHI
 NOTERE
 sa: Pallatet e Lanës
 e Fax - - 355 42 2366
 TIRANË - ALBANI

MIMOZA SADUSHI

[Handwritten signature of Mimoza Sadushi]